



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-GPËSTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	95/16
Nr. i fq. / Br. st	-16-
Data: / Datum	25.05.2016
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E IV-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,
MBAJTUR MË 28 PRILL 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –në kuadër të diskutimit lidhur me rendin e ditës, paraqiti dy pika shtesë në pikën në të ndryshme të cilat edhe i arsyetoj në aspektin ligjor.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-propozoi që propozim-vendimi lidhur me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale të mos futet në rend të ditës për faktin se kjo çështje nuk është urgjente, pastaj se kjo pikë e rendit të ditës nuk i ka kaluar procedurat ligjore duke mos iu nënshtruar shqyrtimit në Komitetin për Politikë dhe Financa andaj i sugjeroi kryetarit të komunës dhe drejtorisë kompetente që kjo çështje të analizohet mirë para se të procedohet në kuvend.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-në emër të grupit kuvendar të LDK-së tha se është bërë një praktik e keqe kur ditën kur mbahet mbledhja e kuvendit sjellën pika shtesë të rendit të ditës të cilat vinë në shpejtësi dhe pa u analizuar mirë. Tutje vlerësoi se kur kemi çështje urgjente atëherë është e arsyeshëm të procedohen pikat shtesë dhe mbështeti propozimin lidhur me ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Ismet Ramen kurse lidhur me propozim-vendimin për dhënien e tokës në shfrytëzim ceku se kjo pikë duhet të analizohet mirë dhe pastaj të sillet në kuvend për aprovim.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se ky kuvend ka për obligim që të jetë kujdestar i respektimit të rregullores dhe ligjit, dhe propozoi që në pikën në të ndryshme të debatohet për fabrikën e ujit për faktin se edhe pas përfundimit të këtij projekti akoma kjo fabrikë nuk po lëshohet në funksion për shkak të pengesave financiare apo për çështje tjera organizative e që janë të lidhura me instancat qendrore të Qeverisë së Kosovës i cila nuk ka ndarë mjete për strukturën kadrovike të kësaj fabrike. Gjithashtu në fund propozoi që në pikën në të ndryshme të diskutohet edhe për objektin e palestrës në fshatin Samadrexhë.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-propozoi që në pikën në të ndryshme të diskutohet lidhur për gurthyesin në fshatin Pasomë për faktin se operatori i cili është marrë me këtë punë ka

shkaktuar shumë dëme në këtë fshatë dhe njëkohësisht premtimi që është dhen për rindërtimin e rrugës nuk është realizuar. Pastaj më vonë i është dhënë një tjetër kompanie në shfrytëzim dhe kërkoi që të bëhet e ditur kushtet me të cilat operon ajo kompani si dhe për obligimet që ka pasur kompania paraprake për faktin se në këtë fshat janë dëmtuar afro 30 shtëpi dhe për këtë nuk ka dhënë askush përgjegjësi.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se praktika e sjelljes së pikave shtesë të rendit të ditës në ditën e mbajtjes së mbledhjes së kuvendit ka ndodhur edhe në të kaluarën dhe se kjo bëhet për shkak të natyrës urgjente të çështjeve të cilat duhet ta marrin aprovimin e kuvendit. Tutje arsyejoj se çështja e dhënies në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale në fshatin Bukosh është e natyrës urgjente për faktin se komuna jonë është përfituese e një projekti nga BE-ja në vlerë prej 500,000 € me një bashkëfinancim me komunë me vlerë prej 50,000 € për themelimin e një ndërmarrje sociale për grumbullimin, selektimin dhe paketimin e mbeturinave të riciklueshme të letrës, plastikës dhe mbetjet tjera të metaleve të riciklueshme. Pastaj shtoi se objekti im kësaj ndërmarrje është ndërtuar dhe është pajisur me pajisje të nevojshme. Në elaborimin e mëtejme të këtij projekti njoftoi anëtarët e kuvendit se ky projekt është zhvilluar mbi bazën e një marrëveshje tri paleshe BE-së Komunës së Vushtrrisë dhe Kompanisë Konsulente “Rea” ku, kjo e fundit është implementuese e këtij projekti dhe se në bazë të kësaj marrëveshje parashihet themelimi i kësaj ndërmarrje sociale. Lidhur me këtë çështje theksoi se pasi që ligji për ndërmarrjet sociale akoma është në procedurë të draftimit dhe se në kohën kur është bërë kjo marrëveshje është menduar që ky ligj do të fuqizohet që kjo ndërmarrje do të kishte mundësi të licencohet por e vërteta është se ai ligj sot e kësaj dite nuk është aprovuar nga kuvendi i Kosovës. Në vazhdim ai duke bërë krahasime me Suedinë tha se ky shtet nuk e ka fare të aprovuar ligjin për këto lloj ndërmarrjes dhe Komuna e Växjö në Suedi i financon këto ndërmarrje sociale. Mandej ai duke ju referuar këtij projekti tha se kuvendi i komunës është ai i cili ka marrë vendim për ndarjen e parcelës për ndërtimin e kësaj ndërmarrje, dhe ky objekt është e ndërtuar por tani kanë dalë në sipërfaqe probleme dhe pengesa ligjore për themelimin e kësaj ndërmarrje e cila e ka statusin juridik të OJQ-së. Lidhur me këto pengesa juridike për themelimin e kësaj ndërmarrje komuna ka kërkuar sqarime ligjore nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal por asgjë nuk është bërë në këtë drejtim dhe kjo mund të ndikojë në humbjen e donacionit dhe si përfundim dështimi i këtij projekti. Në fund ai i propozoi kuvendit që kjo pikë të futet në rend dite dhe për këtë të merret një vendim i cili pastaj do të vlerësohet nga ministria gjegjëse se a është ai vendim i ligjshëm apo jo. Kurse lidhur me çështje e gurëthyesit në fshatin Pasomë propozoi që të merren informata dhe kuvendi të informohet në mbledhjen e radhës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se përpos që ky propozim-vendim nuk i ka kaluar fazat ligjore, kuvendi sot gjendet në një konfuzion për faktin se nuk e din se si të veprojnë lidhur me këtë çështje për arsye se në bazë të asaj marrëveshje të aprovuar në kuvend ka qenë obligim i investitorit që të menaxhojë procesin e mbeturinave në këtë ndërmarrje. Në fund propozoi që për këtë pikë të rendit të ditës të merret mendimi i zyrës ligjore dhe për këtë çështje kërkohet një pauzë prej pesë minutave për konsultim me grupeve kuvendare të përfaqësuara në kuvend.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit –tha se kjo pikë e rendit të ditës është propozuar nga kryetari i komunës dhe është e nënshkruar nga ana e tij ku bëhet fjalë për një projekt i cili ka filluar para dy viteve dhe tani ky projekt kërkon përkrahje e kuvendit mandej ai e përkrahi idenë që kjo pikë të futet në rend të ditës dhe për këtë çështje propozoi që të merret mendimi i zyrës ligjore.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit –tha se pas konsultimeve me shefat e grupeve kuvendare u pajtuan që kjo pikë të futet në rend të ditës në pikën në të ndryshme me kusht që të merret mendimi i zyrës ligjore dhe arsyejoj se ky propozim-vendim duhet të shqyrtohet për faktin se kemi të bëjmë me një donacion si dhe me gjendjen jo të mirë të ambientit.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së;
2. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore për muajt: janar, shkurt dhe mars 2016;
3. Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës Ligjore;
4. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndarjen e bursave për vitin 2015;
6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim të pronës publike të Komunës;
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projektit shkencor (monografisë), “Batalioni i IV Rexhep Musa”;
8. Shqyrtimi i Informatës tremujore të Zyrës për Komunikim me Publikun;
9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale;
10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje në Komunën e Vushtrrisë;
11. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për Ismet Ramen.
 - b). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.
 - c). Shqyrtimi i Informatës lidhur me fabrikën e ujit.
 - ç). Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimin e palestrës sportive në fshatin Samadrexhë.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

2. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore për muajt: janar, shkurt dhe mars 2016.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se hartuesi i kësaj informate nuk na ka ofruara ndonjë pikë të veçantë se çka e ka karakterizuar këtë periudhë tremujore të raportimit për të hyrat vetanake. Tutje shtoi se materiali i prezantuar ka gabime në vitet kur bëhen krahasime të cilat duhet të përmirësohen. Pastaj duke ju referuar shënimeve të dhëna në këtë informatë theksoj se arkëtimet për këtë periudhë nuk janë konform planit dhe ato janë në vlerën prej 66%, e që shihet se ka nevojë për një mobilizim për realizimin e inkasimit të të hyrave vetanake sepse të hyrat që vinë nga granti i përgjithshëm janë çështje tjetër që ofrohen si të gatshme. Mandej ai ritheksoj se të hyrat nga dhëna në shfrytëzim e pronës bujqësore janë 0 % kurse, kur kemi të bëjmë me dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në përgjithësi planifikimi ka qenë që të inkasohen 20.000€, kurse janë realizuar 8629 €. Gjithashtu edhe shpenzimet nuk i kemi të realizuara sipas planit dhe se edhe përkundër kimeve të mirë që ka mbretëruar gjatë stinës që e lamë pas nuk kemi pasur realizim të investimeve kapitale kur realizimi ka qenë në vlerën prej 15 %, kurse lidhur me shpenzimet shihet se në disa kategori parimisht kemi kursime kurse në disa tjera kemi rritje në krahasim me vitin e kaluar siç është kategoria e ushqimit dhe pijeve dhe shpenzimet për dreka zyrtare ku në vitin e kaluar për këtë periudhë kemi pasur të shpenzuara 3440 €, për këtë vit shpenzimet për të njëjtën periudhë kanë arritur në vlerën prej 6813 €. Pastaj tek kategoria mirëmbajtja e auto rrugëve lokale shpenzimet janë në vlerën prej 15.000 € por nuk dihet se për cilat rrugë bëhet fjalë. Mandej tek shpenzimet e ujit, rrymës dhe telefonit kemi kursime krahasuar me vitin paraprak. Andaj mund të thuhet se në krahasim me vitin e kaluar

kemi një ndryshim në kuptimin pozitiv të fjalës sa i përket shpenzimeve dhe ri përsëriti se është i nevojshëm mobilizimi për rritjen e të hyrave vetanake. Në fund tha se projektet kapitale të parapara për vitin 2016 duhet të realizohen sipas aftit dhe me cilësinë e duhur.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-tha se kur flasim për informatën për të hyrat dhe shpenzimet janar-mars 2016 atëherë dalin në pah shumë gabime në tabelat krahasuese të raportit për të hyrat dhe shpenzimet në periudhën janar-mars e që kjo është rezultat i papërgjegjësisë dhe ngutis në hartimin e këtij raporti. Andaj tek tabelat e të hyrave dhe shpalosja ka janë vendosur të hyrat për vitin 2015 në shumë prej 306,775.50 € në të njëjtën periudhë raportuese në vend që të vendoset te të hyrat e vitit 2016 për periudhën janar-mars. Pastaj në tabelën përmbledhëse të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike kemi një mospërputhje të të dhënave në krahasim me tabelën e shpenzimeve detale sipas kodeve ekonomike për shembull mallra dhe shërbime në tabelën përmbledhëse kemi shumën 318,09,0.45 € kurse në tabelën sipas kodeve ekonomike për mallra dhe shërbime kemi shumën 314,365.030 €. Mandej edhe tek investimet kapitale kemi dallime ku në tabelën përmbledhëse kemi shumën 327,94.054 € kurse në tabelën sipas kodeve ekonomike kemi shumën 344,164.040 €. Kurse për shpenzimet komunale subvencionet dhe transferet të dhënat janë në rregull dhe përputhen në të dy tabelat. Kur bëhet fjalë për krahasimin e të dhënave për shpenzimet komunale sipas kodeve ekonomike për këtë periudhë raportuese në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar del se kemi rritje drastike të shpenzimeve p.sh te kodi i shërbimeve kontraktuese kemi një rritje të shpenzimeve për afro 70,000.00 €, pastaj tek kodi i pajisjeve nënjë mijë ero kemi një rritje të shpenzimeve prej 10,000.00 €, tek drekat zyrtare kemi rritej prej 3,000.00 € në krahasim me vitin paraprak, tek shpenzimet për ngrohje janë 7,000.00€ kur dihet se dimri këtë vit ka qenë i “butë” mandej riparim i kerreve afro 5500 € andaj si përfundim del se kemi rritje të shpenzimeve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Abit Abiti, ZKF-paraqiti sqarime profesionale lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se ka marrë një vendim me të cilin do të ulen shpenzimet për pije për administratën komunale. Tutje shtoi se është bërë shumë bujë kur flitet për shpenzimet në kategorinë e drekave dhe njoftoi se faturat e shpenzimeve të çerdhes së qytetit në vlerë prej 3.000 € janë bartur në këtë kategori dhe si rezultat i kësaj del se kemi rritje të shpenzimeve për këtë kategori. Pastaj duke ju referuar inkasimit të të hyrave vetanake vlerësoi se tremujori i parë i vitit është më problematik në inksimin sidomos në kategorinë e taksës në firmë dhe tatimit në pronë. Mandej njoftoi kuvendin se muaji prill i këtij viti është më i suksesshëm në realizimin e të hyrave si dhe ceku se Drejtoria e Financave ka pasur mjaftë probleme në inkasim pas aprovimit të ligjit për faljen e borxheve. Në fund apeloj tek të gjithë qytetaret që bëjnë pagesat e obligimeve tatimore dhe taksat sepse në të kundërtën mund të ballafaqohen me procese gjyqësore në gjykatën përmbartimore.

3. Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës Ligjore.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit-tha se informata e hartuar nga zyra ligjore është e mangët ku thuhet se gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë në 35 seanca gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri si dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë , por në këtë kontekst nuk është cekur se sa konteste gjyqësore janë fituar nga komuna si dhe sa janë humbur. Pastaj thuhet se me datën 21 janar 2016 Zyra Ligjore ka pranuar nga gjykata Aktgjykimin C.nr102/14 të datës 20 janar 2016 me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit NN nga Vushtrria ku vlera e kontestit është 519,248.00 €, lënda gjendet në Gjykatën e Apelit sipas ankesës së paditësit dhe se në këtë rast nuk precizohet se për cilën ndërmarrje bëhet fjalë si dhe nuk flitet për natyrën e kontestit për faktin se bëhet fjalë për një vlerë të lartë financiare dhe se ky kontest do ta dëmtoj buxhetin e komunës në rast se humbet. Prandaj nga të sipër cekurat kërkon nga

zyra ligjore që për mbledhjen e ardhshme të kuvendit të informohet me shkrim se sa konteste janë të humbura dhe sa konteste kanë përfunduar në favor të komunës gjatë vitit 2015 dhe për katër mujorin e vitit 2016. Pastaj se zyra ligjore ai i ka shterur të gjitha mjetet juridike për mos humbjen e kontesteve gjyqësore si dhe a është ndërmarrë ndonjë masë ndaj përgjegjësve që e kanë përfaqësuar komunën në këto konteste gjyqësore.

Idriz Muzaqi, zyrtar ligjor-duke u përgjigjur në pyetjet e anëtares së kuvendit theksoj se komuna as nuk i humb e as nuk i fiton kontestet gjyqësore për faktin se këto lëndë i vendosin gjykatat kompetente. Tutje shtoi se në rastin e raportimit para kuvendit kemi të bëjmë me tremujorin e parë të vitit 2016 ndërsa këtu u kërkuan informata për vitin 2015. Mandej ai duke referua për aktivitetin e zyrës ligjore njoftoj se në vitin 2015 gjykata ka vendosur vetëm një lëndë në disfavor të komunës ku vlera e kontestit ka qenë 800 €. Lidhur me faktin se përse nuk është bërë publike emri i ndërmarrjes të cekur si NN të cilës i referohet anëtarja e kuvendit vlerësoi se kjo çështje nuk do të zbulohet për faktin se gjërat e tilla po dalin jashtë komunës dhe po bëhen objekt i bisedave nëpër kafenetë e qytetit andaj me qëllim të ruajtjes së autoriteti të komunës dhe konfidences emri i këtij subjekti juridik nuk do të bëhet i ditur për publikun.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se çështja e Ndërmarrjes Publike “Stacioni i Autobusëve” është përcjellë më herët nga AKM-ja e tani edhe nga AKP-ja si një “patate e nxehtë” në “duart e komunës” dhe apeloj që propozimi i zyrës ligjore që kjo ndërmarrje të hiqet nga lista nr. 2 e Ndërmarrjeve Publike Lokale duhet të merret seriozisht dhe duhet të vepohet shpejtë për zgjidhjen e këtij problemi.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se zyra ligjore është ndër zyrat që ka punuar dhe po punon në mënyrë profesionale. Pastaj duke ju referuar ndërmarrjes lokale “Stacioni i Autobusëve” njoftoi se me një plotësim-ndryshim të një ligji ndërmarrjet e ashtuquajtura “Stacioni i Autobusëve” AKP-ja i ka bartur në pronësi të komunës dhe për këtë çështje komuna patë filluar disa përgatitje duke ndarë disa mjete financiare për funksionalizimin e kësaj ndërmarrje. Mirëpo bartja e pronësisë nga ana e AKP-së tek komuna e kësaj ndërmarrje ishte bërë me qëllim jo të mirë për faktin se kjo ndërmarrje tanimë e falimentuar kishte pas shumë obligime nga një kontest gjyqësor tepër i gjatë dhe i komplikuar i filluar qysh në vitin e largët 1986. Në vazhdim ai paraqiti një historik të kontestit gjyqësor ku palë kanë qenë disa subjekte juridik si Ndërmarrja “Kosova Trans” ish Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë pronaret e tokave që iu janë shpronësuar pronat, ku ndër të tjera informoi se ish kuvendi i komunës e kishte shpallë zonë të interesit hapësirën ku sot ndodhet “Stacioni i Autobusëve” që dikur ka qenë pronë private dhe në atë kohë ndërmarrja “Kosova Trans” kishte marr për obligim që këtë hapësirë ta shpronësoj dhe tani ne nuk kemi informata se pronarëve privat a iu kanë paguar parat apo jo por se këta persona vazhdimisht janë ankuar në gjykatat e ish Jugosllavisë por edhe me vonë. Pastaj në kontestin mes AKP-së dhe pronarëve privat të këtyre pronave gjykata kishte vendosur në favor të këtyre të fundit por në kohën e mbulimit të kompensimit AKP-ja përmes një shkrese në mënyrë të padrejtë e kishte ngarkuar komunë. Në fund tha se komuna i ka fituar gati të gjitha kontestet që kanë të bëjnë me rastin e ndërmarrjes “Stacioni i Autobusëve”, dhe bëri të ditur se në aktgjykimet e lëshuara nga gjykatat në asnjë rast nuk janë bazuar në shkresën të cilën e ka nënshkruar kryetari i komunës për pranimit-dorëzimin e pronësisë së kësaj ndërmarrje, si dhe apeloj tek anëtarët e kuvendit që të kërkojnë nga Kuvendi i Kosovës që të bëhet ndryshimi i ligjit dhe kjo ndërmarrje të hiqet nga lista e ndërmarrjeve publik lokale.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 28 prill 2016 ka kërkuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nga Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që të iniciohet procedura për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.

03/L-087 për ndërmarrjet publike që "Stacioni i Autobusëve" në Vushtrri të hiqet nga lista nr.2 e ndërmarrjeve publike lokale.

4. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-tha se kjo informatë është e hartuar mirë dhe uroj për atë se nuk kemi asnjë rast të helmimit me ushqime në komunën tonë. Tutje shprehu kundërshtimin e saj për ekspozimin e artikujve ushqimorë sidomos të pemëve dhe perimeve në diell kur dihet se në këtë formë ndodh humbja e cilësisë së këtyre artikujve. Pastaj ajo vlerësoi se drejtorja gjegjëse ka mungesë të stafit profesional dhe sugjeroi që kjo drejtori të ketë konsulta me ekspertet e kësaj fushe dhe kërkoi që në informatat vijuese të ketë edhe analiza kimike biologjike si dhe të informohet edhe për gjendjen e frigoriferëve nëpër marketet tona.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit -tha se mungojnë kontrollat e inspektorëve gjegjës ushqimor në viset rurale dhe këtë e kanë kërkuar shumë qytetarë. Gjithashtu duke ju referuar informatës ku rezulton se tri raste janë kontrolluar ku është gjetur kontaminim në të tria këto raste dhe ku nga këto tri raste vetëm njëra është proceduar për ekzaminim kur tjerat fare nuk janë kontrolluar.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-tha se në faqen 2 të kësaj informate ku bëhet fjalë për ankesat në lidhje me sigurinë e produkteve ushqimore drejtuar Drejtorisë për Inspektime ku thuhet se vetëm 5 ankesa kanë qenë në favor të konsumatorit kurse 2 të pa bazuara dhe nëse e marrim për bazë faktin se tregu kosovar përgjithësisht është i varur nga importi e që do të thotë se numri më i madh i produkteve ushqimore vijnë nga tregjet e jashtme e që disa nga këta artikuj nuk i përmbushin standardet apo janë të dëmshëm për shëndetin tonë. Mirëpo siguri nuk ka as sa i përket prodhimeve vendore ku zakonisht kemi probleme me afatin e qëndrueshmërisë kjo do të thotë që kualiteti i ushqimit që ne e konsumojmë nuk e kontrollon askush dhe si rrjedhojë u mbetet konsumatorëve ti analizojnë vetë produktet ushqimore që ata i blejnë. Tutje ajo vlerësoi se si duket jemi mësuar të jetojmë duke na u shkelur të drejtat elementare për faktin se konsumatorët tanë nuk ankohen asnjëherë edhe atëherë kur tregu iu ofron ushqime të pashëndetshme mirëpo, kjo duhet të ndryshoj sepse ushqimi nuk është lluks por është domosdoshmëri dhe në këtë aspekt duhet të bëhem më të zellshëm në mbrojtjen e të drejtave të cilat na takojnë ligjërisht sepse, përveç shpenzimit të parasë produktet e dyshimta në treg janë kërcenim i vazhdueshëm për shëndetin tonë. Në fund tha se shpreson që gjendja e sigurisë së produkteve ushqimore në komunën tonë të jetë ashtu se si është paraqitur në këtë informatë por ajo ndan mendimin se gjendja është ndryshe për faktin se ka problem të mëdha lidhur me ushqimin që na ofrohet nëpër lokalet tona.

Gëzim Saraqi, drejtor i DI-së-paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndarjen e bursave për vitin 2015.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit-tha se i vjen mirë që nga 32 student sa kanë përfituar bursa 22 prej tyre janë të gjinisë femërore apo shprehur me përbindje përmbi 70% dhe me këtë femrat po dalin si më të suksesshme në studime. Tutje shtoi se përfitueset e bursave në drejtimin e mjekësisë tri kandidatet e para janë me notë mesatare mbi 9 dhe pyeti se me këtë mesatare këto studente është dashur të fitojnë bursën universitare dhe kërkoi të di se cila ka qenë arsyeja për një gjë të tillë. Mandej ai kërkoi që të bëhen ndryshim në rregulloren e bursave që studentet e mjekësisë ata të Fakultetit Teknik dhe të matematikës të mund të përfitojnë bursë komunale por edhe atë universitare. Këtë ai e arsyetoj me faktin se këto drejtime janë prej drejtimeve më të vështira dhe në disa prej tyre kemi zvogëlim të numrit të studentëve dhe kjo do të ndikonte pozitivisht në stimulimin e studentëve për të studiuar këto drejtime.

Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me informatën në fjalë.

6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim të pronës publike të Komunës.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit-paraqiti dy propozime tek neni 1 pika .1.3 të shiritit ndarës i ngastrës kadastrale 3536 në rr. “Skënderbeu” me kapacitet prej 92 vend parkimeve ky lokalitet përfshin hapësirën e quajtur tek “banesat e bardha” dhe siç dihet tek hyrja e kësaj ndërtese kemi vend parkim për secilën hyrje kurse ndërtesa afër saj tek marketi i quajtur “Kastrioti” ajo gjithmonë e ka shfrytëzuar shiritin ndarës të parkingjeve dhe kishte me qenë mirë që ato katër parkingje të futen në këtë propozim-vendim që do të lejoheshin për ata banorë. Pastaj tek pika 6.1 lidhur me çmimin propozoi që në zonën e parë çmimi për një vend parkim të jetë 2 € në zonë e dytë çmimi të jetë 1.50 € kurse për zonën e tretë çmimi të jetë 1 €.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit –tha se para se të vendoset për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave është mirë që të përcaktohet në vend parkim për taksit në rr. “Dëshmoret e Kombit” të cilët po përballen me probleme të ndryshme duke bllokuar rrugën tek përmendorja e “Adem Jasharit” në kundërshtim me rregullat e komunikacionit andaj kërkoi që për këtë çështje të gjendet një zgjidhje.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se në atë lokalitet ekziston vend parkimi për dy kompani të taksive por në atë hapësirë operojnë edhe disa taksist tjerë persona privat dhe një vend parkim për taksist është përcaktuar tek ish objekti “Kosova” dhe mirë kishte me qenë që një i tillë të përcaktohet në atë pjesë të qytetit. Gjithashtu ai propozoi që çmimi fillestar të përcaktohet në shumë fikse për një parcelë me të gjitha vend parkingjet në mënyrë që ti shmangemi manipulimeve që mund të ndodhin nëse shkojmë me vendosjen e taksave për secilin vend parkim.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se mungesa e ligjit për ndërmarrjet sociale është evident dhe sikur të ishte ky ligj do të mund ti favorizonim disa kategori të personave me nevoja të veçanta dhe të tjerët që janë me gjendje jo të mirë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se kishte me qenë mirë që komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të ketë parasysh që të aplikoj metodën e poentimit dhe kështu ti favorizoj OJQ apo kategoritë e personave me nevoja të veçanta. Në fund ai lidhur me propozim-vendimin në fjalë propozoi me sa vijon: tek pika 1.1 e propozim-vendimit të aplikohet shuma fikse prej 80 €, pastaj pika 1.1.2 me shumën prej 138 €, pika 1.1.3 184 €, mandej tek zona e tretë pika 1.2.1 kapacitetit prej 10 vend parkingjeve shumëzuar me 1.5 € shuma e përgjithshme prej 15 € si dhe tek pika 1.2.2 shuma fikse prej 18 €, këto mjetet financiare kompania është e obliguar t’ia paguaj komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 27 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim miratohet paraprakisht propozimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim, prona publike komunale si në vijim:

1.1.Në zonën e parë dhe të dytë përfshihen këto vend parkingje:

1.1.1. Ngastra kadastrale 504 dhe 505 të ish stadiumi i hendbollit me sipërfaqe prej 1,225 m², me kapacitet prej 40 vend parkimeve;

1.1.2. Shiriti i ndarë i ngastrës kadastrale 1116 i rr. „Dëshmorët e Kombit”, me kapacitet prej 69 vend parkimeve;

1.1.3. Shiriti i ndarë i ngastrës kadastrale 3536 i rr. „Skënderbeu” me kapacitet prej 92 vend parkimeve;

1.2. Në zonën e tretë përfshihen këto vendparkingje:

1.2.1. Shiriti i ndarë i ngastrës kadastrale 1102 i rr. „Kruja” me kapacitet prej 10 vend parkimeve;

1.2.2. Shiriti i ndarë i ngastrës kadastrale 1127 i rr. „Halit Quka” me kapacitet prej 12 vend parkimeve.

2. Sipërfaqet e cekura si në pikën 1 të këtij vendimi, jepen në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve.

3. Shfrytëzuesi i pronës komunale do të lidhë kontratë me komunën për shfrytëzim të pronave publike të përmendura në pikën 1 të këtij Vendimi.

4. Komuna rezervon të drejtën e shkëputjes para kohe të kontratës nëse një gjë të tillë e kërkon interesi i përgjithshëm publik. Në këtë rast komuna do ta njoftoj shfrytëzuesin e pronës komunale tre (3) muaj më herët.

5. Çmimet e inkasimit për parkimin e mjeteve motorike janë të përcaktuara në Rregulloren 01 nr. 278/15 për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale.

6. Çmimi fillestar i interesit publik të komunës për të cilin është i obliguar të paguaj përfituesi është me sa vijon:

6.1. Për zonën e parë dhe të dytë për një (1) muaj për një vendparkim: dy (2) euro apo;

6.1.1 Në ngastrën kadastrale 504 dhe 505 me kapacitet prej 40 Vendparkimve çmimi fillestar është 80 €.

6.1.2 Në ngastrën kadastrale 1116 me kapacitet prej 69 vendparkimeve çmimi fillestar është 138 €.

6.1.3 Në ngastrën kadastrale 3536 me kapacitet prej 92 vendparkimeve çmimi fillestar është 184 €.

6.2. Për zonën e tretë për një (1) muaj për një vendparkim: një euro e pesëdhjetë cent (1.5) apo;

6.2.1 Në ngastrën kadastrale 1102 me kapacitet prej 10 vendparkimeve çmimi fillestar është 15 €.

6.2.2 Në ngastrën kadastrale 1127 me kapacitet prej 12 vendparkimeve çmimi fillestar është 18 €.

7. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratave pas lidhjes së tyre.

8. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ta regjistron në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim në periudhë afatshkurtër.

9. Obligohet Komisioni Vlerësues i Ofertave që pas plotfuqishmërisë së këtij Vendimi, t'i zbatojë procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe të Rregullores (QRK) Nr. 23/2013 për Përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projektit shkencor (monografisë), "Batalioni i IV Rexhep Musa";

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se të gjithë jemi që shkruhet historia në mënyrë objektive në kuptimin real që të mbeten dëshmi për atë që ka ndodhur për të tashmen dhe për të ardhmen sepse thuhet se "historia është mësuese e jetës". Tutje ai u ndal tek forma dhe procedura e kësaj çështje duhet të respektohet pa marrë parasysh pasi që bëhet fjalë për parane publike. Pastaj shtoi se nuk ka kurrfarë paragjykimi për ndarjen e këtyre mjeteve për këtë përfutuese por se forma e një ankandi apo e konkurrencës do të ishte më e mirë. Mandej vlerësoi se ndarja e vetëm një pjese për tu shkruar historia nuk e di se sa do të ishte me vend kur dihet se në ZOSH ka pasur një komandë dhe kishte me qenë mirë që historia të shkruhet në mënyrë të tërësishme dhe objektive.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit –tha se nuk është kundër që të shkruhet monografia për "Batalionin e IV" dhe ceku se në ZOSH-ja ka operuar në dy komuna dhe dy Brigada dhe atë Brigada 141 me 4 Batalione, dhe Brigadën 142 në Çiçavic ku kanë operuar 2 Batalione dhe shi për këtë apeloj që mos të ngutemi sepse në të gjitha këto batalione është luftuar dhe vlerësoi se epopeja ma e lavdishme në Brigaden 141 është ajo e "Mejdanit dhe Pretenit", andaj ai në këtë kontekst propozoi që bëhet një marrëveshje mes Komunës së Vushtrrisë dhe asaj të Mitrovicës që të shkruhet historia e ZOSH në tërësi e jo në mënyrë parciale.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit –në emër të grupit kuvendar të LDK-së tha se ky projekt shkencor po bëhet për tri komuna dhe kostoja e këtij projekti është diku më shumë se 10,000 € dhe vlerësoi se shuma e prej 5.000 € e ndarë nga komuna jonë është e lartë pasi që projekti është për tri komuna. Në fund ajo tha se nuk është kundër shkrimit të historisë por se në këtë rast duhet të kontribuojnë që të tri komunat për financimin e këtij projekti.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se ky projekt ka qenë edhe më herët në kuvendi dhe i njëjti ka marrë aprovimin e tij. Tutje shtoi se ky projekt nuk duhet të politizohet dhe njoftoi se për ZOSH janë shkruar disa libra të cilat janë për tu përshëndetur. Pastaj ceku se është mirë që financimi i këtyre projekteve të bëhet në zona të veçanta në këtë rast do të financohet monografia për "Batalionin e IV Rexhep Musa" me luftën e të cilit ndihemi krenar të gjithë. Andaj nga të lartë cekurat apeloj që mos të polemizohet tej mase lidhur me këtë çështje për faktin se këto vlera financiare të cilat janë propozuar për tu ndarë nuk janë mjete të mëdha për tu shkruar historia e jonë e dhimbshme, pastaj organizimi i luftës dhe protagonistët e saj.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit –tha se e ka kuptuar ndryshe këtë projekt për faktin se në këtë rastin paraqitet specifikacioni i shpenzimit të mjeteve për këtë projekt mirëpo autori në mënyrë shumë precize i ka paraqitur tezat dhe specifikimin e projektit. Tutje njoftoi se në Institutin e Historisë ndahen projektet dhe projektin për ZOSH e ka marrë Sabit Syla i cili do ta

trajtoj në tërësi veprimtarin ushtarake dhe luftën në Zonën Operative të Shalës. Në fund tha se këtij projekti duhet ti jepet përkrahja pasi i njëjti ka kaluar në mbledhjen e kaluar dhe tani ne nuk duhet ta kontestojmë vetveten por ta shtyjmë përpara këtë projekt.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit-pasi foli për strukturat organizative luftarake në ZOSH tha se duhet të fillohet të shkruhet historia nga zona operative, pastaj për dy brigadat dhe batalionet duke mos bërë ndarje dhe dallime. Në fund tha se e përkrah këtë projekt por se në të ardhmen duhet të shkruhet për veprimtarin luftarake në tërësi të Zonës Operative të Shalës.

Gani Imeri, drejtor i DSHP-së-njoftoi kuvendin se Ministria e Kulturës i ka ndarë 236,000.00 për financimin e monografive për të gjitha zonat luftarake që kanë operuar në Kosovë. Tutej shtoi se në rastin konkret bëhet fjalë për Institutin Kombëtar të Historisë i cila ka marrë përsipër me i shkruar monografitë në nivel të zonës ky proces ka përfunduar dhe është i sponsorizuara nga Ministria e Kulturës. Pastaj vlerësoi se sa i përket Batalionit të IV dhe masakrës së fshatit Studime në tribunalin e Hagës kanë qarkulluar zëra se fajtor për masakrën e fshatit Studime ka qenë “Batalioni i IV” dhe mendohet se me këtë projekt do të zbardhet e vërteta dhe do të ndriçohet kjo ngjarje për krejt opinionin. Në fund tha se kush është fajtor për masakrën e fshatit Studime ajo dihet por është mirë të shkruhet sepse këto po shkruhet historia jonë e vërtet dhe e dhimbshme dhe se nuk bëhet fjalë për përfitim të personave të caktuar.

Shpresa Rama, drejtoresh e DKRS-së-paraqiti shpjegime lidhur me procedurat e ndarjes së këtyre mjeteve për financimin e këtij projekti ku njoftoi se kërkesa për këto mjete është parashtruar në muajin shkurt nga ana e Sabit Sylës dhe në bazë të kësaj kërkesë e kemi sjellë këtë propozim-vendim për financimin e këtij projekti.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-përsëriti qëndrimin e tij se duhet të bëhet një marrëveshje me Komunën e Mitrovicës për financim të përbashkët të një monografie për tërë Zonën Operative të Shalës. Pastaj shtoi është mirë që kur të shkruhet të jemi të sigurt se po bëhet punë e mirë dhe për gjithë ZOSH. Mandej ai vlerësoi se kush është fajtor për vrasje dhe masakra dihet se është Serbia madje lufta jonë e lavdishme është pastër ku ka pasur respektim të hierarkisë dhe në të ka mbretëruar humaniteti duke mos u ndjekur dhe vrarë civilët dhe robërit e luftës. Në fund tha se personin i cila ka marrë për obligim ta shkruaj këtë monografi ai nuk e njeh por e di se në komunën tonë ka njerëz të cilët dinë të shkruajnë dhe të cilët kanë qenë protagonistë të drejtpërdrejt në luftë andaj këta do të mund të shkruanin në mënyrë shumë të saktë dhe do të dilte një monografi shumë e kompletuar.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit-përsëriti qëndrimin e tij se është pro këtij projekti por duhet në vendim të ceket që “Batalioni i IV Rexhep Musa” ka qenë pjesë e Brigadës 141 “Mih Uka”.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se edhe më herët në këtë kuvend janë marrë vendim për subvencionim të projekteve me emër dhe mbiemër dhe një gjë të njëjtë po e bëjmë edhe sot. Pastaj në anën tjetër përfituesi është drejtor i Institutit Kombëtar të Historisë dhe të njëjtë kanë një marrëveshje me Ministrin e Kulturës për hartimin e monografive dhe kjo aq më tepër e konfirmon faktin se ky projekt është serioz. Mandej ai duke ju referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit për shpalljen e ankandit për këtë projekt atëherë do të vijmë deri tek situata ku nuk do të dinim se kënd ta përzgjedhim. Tutej shtoi se ajo çka e bënë serioz këtë projekt është faktin se ky parashtrues i kërkesës është me titull profesor i asociuar dhe në të njëjtën kohë ne po lidhim një marrëveshje për ofrimin e këtij subvencioni për këtë projekt. Në fund tha se proceduralisht jemi në rregull për të subvencionuar këtë projekt dhe shpreson se ky projekt do të jetë i mirëfilltë në qitjen në dritë të së vërtetës për të kaluarën tonë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit -tha se lidhur me këtë çështje ne si anëtar të kuvendit nuk kemi pasur njohuri dhe tani na u dhanë disa informata të vlefshme. Tutje shtoi se të gjithë e përkrahim dhe jemi që të shkruhet historia e luftës sonë dhe vlerësoi se ky autor nuk mund të japë epilog të argumentuar lidhur me fajësinë apo pafajësinë e dikujt por ai duhet të orientohet në rrafshin objektiv në nxjerrjen në dritë të së vërtetës së luftës sonë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 25 vota "për", tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerën prej pesë mijë euro (5,000 €) nga buxheti i komunës – fondi për subvencione për Sabit Sylën me vendbanim në fshatin Çubrel Komuna e Skenderajt.

2.Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij vendimi ndahen me qëllim të financimit të projektit shkencor-monografisë "Batalioni i IV-të Rexhep Musa".

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

8.Shqyrtimi i Informatës tremujore të Zyrës për Komunikim me Publikun.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-tha se faqja zyrtare e komunës ka nevojë të përmirësohet dhe kërkoi që në këtë faqe të vendoset lista e anëtarëve të kuvendit të këtij mandati pasi që kanë kaluar gati 3 vite dhe ende figurojnë emrat e anëtarëve të kuvendit të mandatit të kaluar.

9.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-paraqiti sqarime hyrëse lidhur propozim-vendimin në fjalë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-tha se parimisht pajtohet për këmbimin e këtyre pronave por shprehu brengjen e tij se Bashkësia Islame e Vushtrrisë ka nisur ndërtimin e një Xhamie në fshatin Bivolak pa e pyetur fare komunën dhe në tokë të komunës d.m.th pa leje ndërtimore për këtë çështje kërkoi sqarime.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-propozoi që të formohet një komision i cili do të merrej me vlerësimin e kësaj çështje në teren dhe kjo pikë ky vendim të votohej në mënyrë të saktë dhe të drejt pa bërë shkelje ligjore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se para se ti ofrohej kuvendit ky propozim Drejtorja për Kadastër është dashur të bëjë vlerësimin si të ndërës ashtu edhe të pronës tjetër e cila do të futet në procesin e këmbimit përmes agjencionit që është autoriteti ekskluziv për vlerësimin e pronave dhe pasi të ish bërë një vlerësim i tillë do të mund të bëhej një përlllogaritje e saktë dhe neve sot do të na prezantohej saktë se sa metra katrore do të merreshin nga ngastra kadastrale në fshatin Zhilivodë dhe sa do të jepeshin në fshatin Bivolak. Në anën tjetër nëse kështu votohej ky propozim atëherë del se kemi marrë një vendim paushall dhe i cili nuk prodhon kurrfarë efekti dhe njëjti prapë do na kthehet në kuvend për tu anuluar. Andaj nga kjo që u tha kërkoi që kjo çështje fillimisht të shkojë në agjencinë për vlerësim të bëhet përlllogaritja dhe vetëm në këtë formë ti ofrohet kuvendit për aprovim.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-tha se e përkrahë propozimin që të jepet në shfrytëzim kjo pronë komunale për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Bivolak për faktin se kjo ka efekt pozitiv në zhvillimin e kultit dhe kjo do të mundësojë të rive që ti shprehin aktivitetet e tyre dhe do të largohen nga rrugët e këqija.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-kërkoi që të jepet opinioni i zyrës ligjore lidhur me ligjshmërinë e këtij propozim-vendimi dhe pastaj i njëjti të aprovohet.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit -tha se me këtë çështje duhet të shikohet ana juridike dhe pastaj i njëjti propozim-vendim të aprovohet.

Idriz Muzaqi, zyrtar ligjor-tha se dokumenti në fjalë ka qenë në zyrën ligjore për shqyrtim dhe i njëjti ka marrë vizën për procedim në kuvend në këtë formë çfarë është. Pastaj shtoi se gjendje në kadastër nuk është e mirë dhe kjo dokumentohet me faktin se prona në oborr të

shkollës është regjistruar në emër e Këshillit të Bashkësisë Islame tregon më së miri. Mandej ai sqaroi se parcela në fshatin Zhilivodë do të shfrytëzohet për të njëjti qëllim dhe nuk do të parqet kurrfarë shqetësimi për banoret lokal, kurse banoret e fshatit Bivolak kanë parashtruar peticion që ajo parcelë të ndahet për ndërtimin e Xhamisë dhe në këtë drejtim nuk sheh ndonjë pengës që ky vendim të aprovohet.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 27 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim , Komuna e Vushtrrisë bënë këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, pjesë nga parcela kadastrale P-70202006-00278-1, në sipërfaqe prej 898m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4314m² Zona Kadastrale Bivolak, pronë e Komunës së Vushtrrisë me parcelën kadastrale P-70202033-00148-3 në sipërfaqe prej 898m² Zona Kadastrale Zhilivodë, pronë e Bashkësisë Islame në Vushtri.

2.Këmbimi i pronave, të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të sigurimit të hapësirës për nevojat e Shkollës Fillore në Fshatin Zhilivodë.

3.Obligohet Kryetari i Komunës që në afat prej pesë (5) ditësh, pas aprovimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës të bënë kërkesë në Ministrinë e Financave-ZVPP-së për vlerësimin e pronave të paluajtshme, të cilat janë objekt i këmbimit si dhe të lidh kontratë për këmbimin e pronave me pronarin e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4.Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë parcializimin e ngastrave kadastrale në sipërfaqen e cekur në pikën 1 të këtij vendimit.

5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje në Komunën e Vushtrrisë.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit –pyeti se sa leje pune janë lëshuar për ndërtimet në komunën tonë, pastaj se a ka shtëpi apo ndërtesë pa leje e cila nuk do të mund të legalizohet pasi që janë ndërtuar në vend specifik apo të papërshtatshëm si dhe ndërtimet pa leje që janë bërë në sistemin e komasacionit apo sistemin e ujitjes të njëjtat a do të legalizohen si dhe a ka mundës ligjore për një legalizim të tillë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se në bazë të kësaj informate del se komuna jonë është më mirë në regjion se komunat tjera ku kemi 59 aplikacione për legalizim të ndërtimit pa leje edhe pse kjo tregon për një gjendje jo të mirë për faktin se kemi mjaft shumë kërkesa për këto lloj ndërtimesh dhe se sensibilizimi i qytetarëve është bërë në mënyrë të vazhdueshme. Në këtë relacion ai vlerësoi se duhet të bëhen analiza se përse është kaq i vogël ky numër i aplikusve a kemi të bëjmë me mos interesim të qytetarëve apo është mos mundësia e përballimit të kostos nga qytetarët. Në fund tha se nëse dëshirojmë të vendosim rend atëherë duhet të shikohet gjendja e vështirë e qytetarëve për lehtësimin financiar të këtij procesi dhe kërkoj që gjatë këtij procesi ti jepet rëndësi e veçantë tokave nënë sistemin e komasacionit.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së-paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendi.

11. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për Ismet Ramen.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej një mijë e pesëqind euro (1.500 €) nga buxheti i komunës – fondi për subvencione për Ismet Ramen me banim në fshatin Stanoc i Poshtëm, Komuna e Vushtrrisë.

2.Shuma e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të shërimit të sëmundjes së tij.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

b).Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se në bazë të opinionit ligjor të dhënë nga zyra ligjore del se propozim-vendimi i procedura në formën e tillë nuk është në pajtim me ligjin, sepse ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimi e pronës së paluajtshme të komunës nuk saktëson se kuvendi mund të jep pronë në shfrytëzim pa përfitim të komunës. Tutje shtoi se me këtë propozim-vendim në një mënyrë pretendohet të përjashtohet konkurrenca lidhur me dhënien në shfrytëzim të kësaj prone për arsye se në nenin 2 të këtij propozim-vendimi thuhet: prona e komunës e cekur në nenin 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim pa kompensim, gjë e cila u definua se nuk është e lejueshme ligjërisht pastaj vazhdon citati: prona i jepet entitetit legal i themeluar për qëllim të menaxhimit të mbeturinave të riciklueshme-grumbullimit selektimit dhe paketimit të letrës dhe plastikës. Në këtë kontekst ai propozoi që pas marrjes së opinionit ligjor ky propozim-vendimi mund të procedohet me korigjimin e nenit 2 të tij dhe formulimi i këtij nenin do të ishte si në vijim: *Prona e komunës e cekur në nenin 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim me kompensim me çmim fillestarë prej 100 € për të gjithë ofertuesit dhe oferta më e suksesshme gjegjësisht kriterit për dhënien në shfrytëzim do të jetë çmimi më i lartë i ofruar nga cildo qoftë operator ekonomik.* Në fund tha se në këtë formë mund të procedohet dhe aprovohet ky propozim-vendim duke ja shtuar edhe pasuesin se operatori ekonomik nuk duhet të jetë i licencuar për faktin se vetëm kompania “Uniteti” e ka një drejt të tillë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-përsëriti qëndrimin se shpejtësia në nxjerrjen e ligjeve ka bërë që ato ligje të jenë me shumë defekte të cilat po shkaktojë shumë pasoja edhe për komunat dhe qytetarët tanë. Tutje në kontekstin për të cilin bëhet fjalë ceku se për projektin për menaxhimin e mbeturinave ekziston një donacion prej 550,000.00 € nga BE-ja dhe është lidhur një marrëveshje mes Kompaninë “Rea” dhe komunës dhe në këtë marrëveshje si dhe në vendimin kuvendit për ndarjen e një parcele parashihet themelimi i ndërmarrjes sociale të cilën ndërmarrje e themelon vetë komuna. Pastaj ai duke interpretuar ligjin për dhënien e pronës në shfrytëzim ceku se neni 10 i këtij ligji ku thuhet: dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale për rastet e veçanta mandej në piken 1.2 të këtij neni thuhet se procedurat e konkurrimit nuk zbatohen për rastet si në vijim: përfaqësitë diplomatike dhe konzullare, organizata institucionet ndërkombëtare që kanë marrëveshje me Republikën e Kosovës dhe në rastin konkret komuna jonë ka marrëveshje me BE-në. Në fund tha se është e pa kuptimit të dalin kesi lloj barrierash për këtë subjekt (OJQ) e cila do të merret me riciklimin e mbeturinave dhe ceku se është për aprovimin e këtij propozim-vendimi ashtu si është hartuar nga ana e Drejtorisë për Ekonomi.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se nuk është mirë që në këtë formë anëtarët e kuvendit të sfidohen duke i sjellë para aktit të kryer duke ju thënë se “ata nuk janë të interesuar

ta japin në shfrytëzime këtë pronë” Pastaj ai duke ju referua nenit 10 të ligjit për dhënien e pronës në shfrytëzim tha se nuk bëhet fjalë për dhënien në shfrytëzim të pronës për Komisionin Evropian por për një OJQ, dhe nëse është fjalë për dhënien e pronës në shfrytëzim për një subjekt atëherë dihet se cilat procedura i ndjek kuvendi.

Idriz Muzaqi, zyrtar ligjor-tha se ky dokument nuk ka kaluar në zyrën ligjore dhe shtoi se komentet e bëra lidhur me nenin 10 të ligjit për dhënien e pronës në shfrytëzim nga ana e kryetarit të komunës i referohen marrëveshjeve të cilat mund ti lidhë Republika e Kosovës me institucionet dhe organizata ndërkombëtare, dhe ceku se komuna jonë nuk e prezanton Republikën e Kosovës dhe në qoftë se do ishte se ka marrëveshje me komuna e Kosovës atëherë çdo gjë do të ishte e qartë. Mandej tek çështja e kompensimit vlerësoi se nuk dilemë se ligji e një vetëm formën e dhënies në shfrytëzim me kompensim duke përcaktuar çmimin fillestarë për pronë e dhënë në shfrytëzim. Në fund ai ju sugjeroi anëtarëve të kuvendi që në rastin konkret duhet të respektohen procedurat e ankandit pastaj duhet të vendoset çmimi fillestarë si dhe operatori ekonomik duhet ti plotësojë kushtet sipas ligjit për menaxhimin e mbeturinave duke u përfillë kushtet e licencës.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se me këtë projekt po synohet themelimi i një ndërmarrje sociale, duke ju ofruar ndihmë një kategorie të personave me nevoja të veçanta, duke stimuluar punësimin, por vlerësoi se në këtë formë po dalim kundër vetë vetës sonë dhe duke i lanë me një anë interesat e qytetarëve.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-tha se në bazë të vendimit të aprovuar më herët nga ana e këtij kuvendi ka qenë obligim që ajo ndërmarrje sociale për menaxhimin e mbeturinave pas kalimit të afatit prej 3 viteve është dashur ti kthehet komunës dhe shtoi se nëse kjo është kështu atëherë nuk kemi arsye për të mos e votuar këtë propozim-vendim në të kundërt ai do ti kërkoj mjetet tjera juridike për ta shtyrë dhe ndriçuar këtë çështje.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit -tha se në bazë të nenit 83 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komuna ka të drejti ti adresohet Ministrisë së Pushtetit Lokal për konsultim paraprak, andaj ne si kuvend mund ta shfrytëzojmë këtë të drejtë dhe ta referojmë çështje për të marrë mendimin profesional nga niveli qendror para se këtë çështje ta votojmë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se më herët ka kërkuar interpretim ligjor nga ministria gjegjëse lidhur me çështje në fjalë por asnjë përgjigje nuk ka marr nga ana e tyre. Pastaj ai apeloj qe kuvendi ta votoj propozim-vendimin ashtu qysh është hartuar nga ana e drejtorisë pastaj i njëjti të dërgohet për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi që Propozim-vendimin në fjalë ta referoj për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal konform nenit 83 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Në vazhdimi kuvendi vendosi që dy pikat e poshtë shënuara ti shqyrtoj bashkërisht.

c). Shqyrtimi i Informatës lidhur me fabrikën e ujit.

ç). Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimin e palestrës sportive në fshatin Samadrexhë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-tha se jemi informuar se fabrika për përpunimin e ujit teknikisht ka përfunduar por se probleme janë shfaqur me çështjet kadrovike dhe se kemi mungesë të mjeteve për financimin e saj. Tutje ai inkurajoj kuvendin për ofrimin e mbështetjes për kryetarin e komunës për t’iu adresuar me shkresë zyrtare Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit dhe Ministrit të Financave të Qeverisë së Republikës së Financave për të kërkuar nga ta ndihmë në zgjidhjen e kësaj çështje me rëndësi jetike për

qytetarët tanë. Në të njëjtën kohë kërkoi që ti adresohet me shkresë edhe Ministrisë së Kulturës për prolongimin e punimeve në ndërtimin e palestrës sportive në fshatin Samadrexhë.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-tha se disa herë kemi diskutuar lidhur me lëshimin në funksion të fabrikës së ujit dhe kuvendi për këtë çështje ka ndarë një shumë financiare prej 20,000.00 € për KEDS-in për kyçje të këtij impianti në rrjetin elektrik. Andaj lidhur me këtë çështje ai kërkoi që informohet saktë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se është fakt që procesi i lëshimit në funksion i fabrikës së ujit ka marrë një kohë bukur të gjatë. Tutje shtoi se vitin e fundit ka pasur jo seriozitet në funksionalizimin e këtij impianti për furnizim me ujë. Pastaj ai njoftoi kuvendi se në bazë të një para llogarie të bërë nga ujësjellësi Mitrovica del se fabrika për përpunimin e ujit për një vit shpenzon përmbi 600,000.00 € dhe kjo e fundit ka kërkuar nga Ministria e Financave që këto mjetet të sigurohen. Në vazhdim ai ceku se ka biseduar me zyrtaret e Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë çështje dhe ata kanë premtuar se kjo çështje shumë shpejt do të zgjidhet. Mandej ai bëri te ditur se në konsulta me Drejtorin e Ujësjellësit i ka sugjeruar atij që të bëjë rekrutimin e stafit të domosdoshëm që duhet të punojë në këtë fabrikë por si duket ky i fundit po heziton ta bëjë një gjë të tillë në mungesë të ndarjes së mjeteve financiare. Në këtë kontekst ai paralajmëroi se nëse vazhdohen këto zgjatje dhe zvarritje atëherë do të kërkon një konferencë për media për dhen arsyetim para qytetarëve të komunës. Kurse lidhur me projektin për ndërtimin e palestrës sportive në fshatin Samadrexhë njoftoi se vitin e kaluar është dashur të shpallet tenderi për këtë projekt dhe mjetet kanë qenë të planifikuara por si duket nuk është duke ecur kjo punë. Lidhur me këtë çështje ka presion nga ana e qytetarëve dhe ata kanë kërcënuar edhe me protesta, por premtimet nga Ministria e Kulturës janë se ky projekt do të filloj shumë shpejt. Në fund njoftoi se janë edhe disa projektet si Muzeu i Qytetit dhe Qendra Rinore të cilat projekte janë duke u zvarritur nga ana e Ministrisë së Kulturës.

d). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-pyeti kryetarin e komunës lidhur me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për aktoret e Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë të cilët do të udhëtojnë për në Turqi që do të marrin pjesë në një shfaqje në festivalin ndërkombëtarë të teatrit ku do të përfaqësohet Komuna e Vushtrrisë dhe Kosova. Në fund gjithashtu pyeti se a ka dështuar udhëtimi për në Turqi si dhe përse mjetet e ndara për teatrin e qytetit nuk po bartën në xhirollogarinë e teatrit.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se a po funksionon Komisioni për Ndarjen e Banesave Sociale dhe Pagesen Qirasë për faktin qytetaret dëshirojnë të kenë përgjigje, dhe ata nuk janë të informuar për këtë çështje nga Drejtoria e Shëndetësisë.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit-njoftoi për një rast i cili ka nevojë për ndihmë urgjente financiare për shërim bëhet fjalë për Merita Behramin e cila vuan nga një sëmundje e rëndë por edhe vajza e saj nxënës e shkollës fillore gjithashtu është e sëmurë nga veshkat dhe jetojë në kushte të vështira ekonomike, ku të dy prindërit nuk punojnë dhe nuk kanë shtëpi.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-pyeti lidhur me një projekt për vendosjen e një gypi në lagjen "Podrançë" se kush është duke e financuar këtë projekt. Pastaj përsërit qëndrimin e tij se për mbledhjen e ardhshme të kuvendit kishte me qenë mirë të përgatitet një informatë e hollësishme lidhur me eksploatimin shkëmbeve dhe dëmet e shkaktuara në fshatin Pasomë.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHMS-së-tha se rastet sociale janë një problem i madh për komunën për faktin se këto raste ngërthejnë në vete një kosto të lartë financiare me ç' rast komuna nuk mund ti mbulojë të gjitha këto shpenzime. Lidhur me rastin Merita Behramin njoftoi se Drejtoria e Shëndetësisë brenda mundësive të saj e ka ndihmua këtë person me 200 € ndihmë por kur merret për bazë sëmundja prej së cilës vuan kjo ndihmë është më pakë se minimale por ato kanë qenë mundësit e drejtorisë. Pastaj lidhur me çështjen e banesave sociale dhe qirave njoftoi se kryetari i komunës ka formuar një komision i cili po merret me


verifikimin e familjeve që aktualisht ju paguhet qiraja dhe se rregullorja për subvencionet nuk krijon një mekanizëm që e kufizon kohën për ato familje për të cilat komuna iu paguan qiranë dhe kemi familjet të cilave me vite iu paguhet qiraja dhe ato familje për asnjë moment nuk provojnë me zgjidhë problemin e tyre të banimit. Mandej njoftoi se për çështjet e qirasë janë ndarë 24,000.00 € ku 22 familjeve iu mbulohen shpenzimet e banimit për me futë familje të reja në qira duhet të nxirren ndonjëra prej familjeve të cilave iu paguhet qiraja nga ana e komunës.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit tha se e ka lejuar udhëtimin për në Turqi për aktoret e teatrit të qytetit tonë dhe e ka autorizuar Drejtorinë e Prokurimit që zhvilloj procedurat e prokurimit për këtë projekt, por në listën e konkurrimit nuk ka pasur konkurrent të mjaftueshëm dhe për këtë aktualisht ka dështuar ky projekt. Pastaj lidhur me bartjen e mjeteve në xhirollogarinë e teatrit tha se kjo çështje është skeptike se a kemi të dejtë apo jo të bartim këto mjetet për faktin se duhet të dihet forma e shpenzimit të parasë publike. Mandej lidhur me subvencionet për shërim tha se fatkeqësisht kemi shumë qytetarë të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda por të që mundësit financiare të komunës për ti mbuluar këto shpenzime janë minimale, kurse lidhur me rastin Merita Behramit tha se nëse nuk i ka marr shumë prej 200 € ka mundësi që të rishqyrtohet vendimi dhe eventualisht kjo shumë e mjeteve të rritet. Tutje në pyetjen e anëtarit të kuvendit z. Ali Januzit njoftoi se në rrugën “Hazir Gjaka” është duke u vendosur një gyp maxhistrat i ujësjellësit i cili shkon deri në fshatin Smrekonicë dhe ky projekt financohet nga lux development nga Luksemburgu për këtë vlerësoi se është mirë që ky projekt po bëhet por vetëm duhet pasur kujdes që mos të dëmtohet asfalti. Në fund njoftoi për dy donacione që janë për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e Artakollit të financuar nga qeveria zvicerane si dhe për një projekt tjetër të financuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vlerë prej 300,000.00 € për ndërtimin e gypit maxhistrat nga Vushtrria deri në fshatin Gracë ku do të lidhen në rrjetin e ujësjellësit 11 fshatra që është ndërtuar rrjeti sekondarë i ujësjellësit në pjesën lindore të Qytetit të Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:25.

Bastri Duraku

Procesmbajtës



Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit